

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës së Partisë Socialiste
për zgjedhjet kuvendore të 28 Qershorit 2009

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Tiranë

Të nderuar zotërinj,

Ne kemi audituar të ardhurat dhe shpenzimet e Partisë Socialiste, për fushatën zgjedhore të 28 Qershorit 2009, sipas informatës bashkëngjitur. Kjo pasqyrë financiare është përgjegjësi e Drejtimit të Partisë Socialiste. Përgjegjësia ime është të shpreh një opinioin mbi këtë deklaratë financiare bazuar në auditimin e kryer.

Në kryem auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të planifikojmë e kryejmë auditimin për të zotëruar siguri të arsyeshme se kjo pasqyrë nuk përmban anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin mbi bazën e gjithëpërfshirjes së fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet e dhëna në pasqyrën financiare. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës së të ardhurave e shpenzimeve për një qellim specifik. Ne çmojmë se auditimi ynë përbën një bazë të arsyeshme për të shprehur opinionin e pavarur.

Bazuar në auditimin e kryer, me siguri të arsyeshme shpreh opinionin se pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës së Partisë Socialiste jep një pamje të vërtetë e të sinqertë të të ardhurave të realizuara dhe shpenzimeve të kryera gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Shqipërisë të dalë nga zgjedhjet e 28 Qershorit 2009.

Tiranë, 1 Nëntor 2009

Mihal ZIU

Ekspert Kontabël

Shenime për deklarinimet financiare të Partisë Socialiste për fushatën e zgjedhjeve të 28 Qershorit 2009

Fushata për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë ka filluar më 28 Maj 2009 dhe ka mbaruar më 28 Qershor 2009. Aktiviteti financiar në shërbim të kësaj fushate shtrihet në një periudhë më të gjatë se ky kufi zyrtar. Për Partinë Socialiste periudha financiare e fushatës zgjedhore shtrihet në muajt Maj- Qershor- Korrik dhe, më tej këtij kufiri, priten ngjarje të mëvonëshme lidhur me arkëtimin e kështit të dytë të financimit buxhetor dhe për pagesën e disa shpenzimeve të kryera e të faturuara nga disa furnitorë gjatë fushatës zgjedhore.

Në pajtim me parimin e kujdesit, të ardhurat janë evidentuar e deklaruar me arkëtimet faktike, pa përfshirë arkëtimet e pritshme, kurse shpenzimet janë evidentuar e deklaruar në përputhje me kontabilitetin e angazhimit, dmth në vartësi nga momenti i njohjes së detyrimit ose të shpenzimit të kryer, pavarësisht nga koha e pagesës së tyre. Në koherencë me këtë, në kontabilitetin e Partisë Socialiste janë evidentuar dhe deklarohen si shpenzime edhe disa fatura të papaguara për shërbimet e përfituara gjatë fushatës elektorale nga disa furnitorë. Kjo është në pajtim me rregullat e kontabilitetit, që përcakton Ligji "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Sipas këtij kuadri konceptual të të ardhurave dhe shpenzimeve, gjatë auditimit u muarën në konsideratë ngjarje dhe fakte ekonomike e financiare që i takojnë fushatës zgjedhore 2009.

Bazuar në auditimin e kryer, rezulton se situata financiare e fushatës zgjedhore të Partisë Socialiste paraqitet si vijon:

Situata Financiare e Fushatës së Partisë Socialiste për zgjedhjet e 28 Qershorit 2009

Nr.	Emertimi i zërave	Gjithsej shuma ne lek	Sipas raportit financiar				Sipas auditimit				Diferenca + ose - 10 = (9-5)
			Lek	USD	Euro	Totali ne lek	Lek	USD	Euro	Totali ne lek	
a	b	1	2	3	4	5= (2+3+4)	6	7	8	9 = (6+7+8)	
I	Te ardhurat gjithsej	93,607,440	91,096,304	5	16	93,607,440	91,096,304	5	15,97	93,607,440	0
1	Nga fondet e veta te P.S.	73,059,100	73,059,100			73,059,100	73,059,100			73,059,100	0
2	Nga buxheti i shtetit	13,693,204	13,693,204			13,693,204	13,693,204			13,693,204	0
3	Nga donatorët (sponsorizimet)	6,855,136	4,344,000	5	15,97	6,855,136	4,344,000	5	15,967	6,855,136	0
	- me banke	5,078,136	3,079,000	5	11,97	5,078,136	3,079,000	5	11,967	5,078,136	0
	- me arke	100	100			100	100			100	0
	- me materiale publicitare	512			4	512			4	512	0
	- me karburant	1,165,000	1,165,000			1,165,000	1,165,000			1,165,000	0
II	Shpenzimet gjithsej	101,746,870	93,273,970	83,1	4	101,746,870	93,273,970	83,13	4	101,746,870	0
1	Reklama televizive	65,242,261	65,242,261			65,242,261	65,242,261			65,242,261	0
2	Reklama ne radio	1,814,515	1,814,515			1,814,515	1,814,515			1,814,515	0
3	Parrulla e tabela	11,142,751	11,142,751			11,142,751	11,142,751			11,142,751	0
4	Flamuj	732	732			732	732			732	0
5	Karburant	1,165,000	1,165,000			1,165,000	1,165,000			1,165,000	0
6	Shpenzimet telefonike	2,545,254	2,545,254			2,545,254	2,545,254			2,545,254	0
7	Konsulence	7,960,900		83,1		7,960,900		83,134		7,960,900	0
8	Muzike	660	660			660	660			660	0
9	Kancelari	1,723,598	1,723,598			1,723,598	1,723,598			1,723,598	0
10	Te ndryshme	8,760,591	8,248,591		4	8,760,591	8,248,591		4	8,760,591	0
III	Shpenzime mbi te ardhurat (te papaguara)	8,139,430				8,139,430				8,139,430	0

Të ardhurat e siguruar për fushatën elektorale të Partisë Socialiste kapin shumën 93.607.440 lekë. Ato janë të dokumentuara dhe evidentuara në mënyrë korrekte në kontabilitetin e Partisë. Pjesën kryesore të këtyre fondeve Partia Socialiste e ka siguruar nga **mjetet e veta**, në masën 73.059.100 lekë. Nga verifikimi i rrjedhjes së parasë rezulton se PS para se të fillonte fushatën (më 30.4.2009) dispononte gjendje mjetesh monetare (të trashëguara nga vite të kaluara) në shumën 74.739.783 lekë.

Nga **financimi i buxhetit** të shtetit Partia Socialiste ka përfituar deri në datën e nënshkrimit të këtij raporti 13.693.204 lekë. Ato janë bërë hyrje më 20 Qershor 2009 në llogarinë bankare të PS të çelur pranë BKT-së. Evidentimi dhe deklarimi është korrekt me normat kontabile e ligjore.

Burimi i tretë i formimit të fondit të fushatës zgjedhore të Partisë Socialiste janë **donacionet** nga persona të ndryshëm fizikë e juridikë. Në total fondet e siguruar nga donatorët privatë kapin shumën 6.855.136 lekë. Gjithsej janë 17 dhurues fondesh në vlera monetare e material, si më poshtë vijon :

Lista e sponsorizuesve të fushatës së Partise Socialiste për zgjedhjet e 28 Qershorit 2009

Nr.	Emertimi i donatorit	Euro	USD	Leke	Dhurata ne natyre	Gjithsej Leke
1	"Condor" Shpk, Tirane	5.000				645.000
2	"Arela " Shpk ,Tirane	5.000				645.000
3	"Matrix Kontruksion" Shpk,Tirane		5.000			460.000
4	Shoqata e Investitoreve Italiane ne Shqiperi.	1.967				249.136
5	"Kastrati ` Sha, Durres			200.000		200.000
6	" Besa R " Shpk, Tirane			100.000		100.000
7	"Albaco Shoes" Shpk, Tirane			349.000		349.000
8	"Dajti Ekpres" Shpk, Tirane			1.000.000		1.000.000
9	Një sponsor nën kufirin për t'u identifikuar			30.000		30.000
10	Hotel "Kontinental" Shpk, Vorë			100.000		100.000
11	Agim Shenediela			1.000.000		1.000.000
12	Edmond Ziso			400.000		400.000
13	Rudolf Dalipi				20.000 postera	512.000
14	Hysni Bedo				2.000 litra nafte	240.000
15	Leonard Mone				2.500 litra nafte	300.000
16	Ilir Kure				3.000 litra benzine	375.000
17	Shkelqim Shehaj				2.000 litra nafte	250.000
	TOTALI	11.967	5.000	3.179.000		6.855.136

Nga verifikimi rezulton se të gjithë dhuruesit kanë nënshkruar deklaratën e mospasjes konflikt interesi sipas kërkesave të nenit 89 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 " Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Të gjithë dhuruesit e fondeve janë regjistruar në regjistrin e posaçëm, që Partia Socialiste ka mbajtur sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Sponsorizuesit kanë respektuar kërkesën që dhurata në lekë ose kundërvlehtë e donacioneve në sende ose shërbime të mos e kalojë limitin ligjor prej 1.000.000 lekësh. Transaksionet financiare të dhurimit të fondeve në lek dhe në monedha të huaja janë kryer nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare dhe Bankës Credins, ku Partia Socialiste ka çelur llogari të posaçme për fushatën zgjedhore, të cilat i ka deklaruar në KQZ brenda afatit ligjor. Nëpërmjet BKT-së kanë kryer transaksionet e dhurimit shtatë persona juridik, që kapin shumën 2.429.000 lekë, kurse nëpërmjet Bankës Credins kanë dhuruar katër persona fizik e juridik në shumën 2.649.136 lekë.

Me arkë është realizuar vetëm një transaksion dhurimi (nga Hotel Kontinental Sh.p.k. Tiranë në shumën 100.000 lekë), i cili është bërë hyrje në arkë me MA nr.12 datë 12.6.2009.

Dhuratat e konsumuara në mallra e materiale në natyrë kapin shumën 1.677.000 lekë. Këto dhurime janë për 9500 litra karburant me vleftë 1.165.000 lekë dhe 20.000 copë postera publicitare me vlerë 512.000 lekë. Këto dhurata janë konsumuar drejtpërdrejt në aktivitetet e fushatës, pa u bërë hyrje në magazinë. Sasia e tyre vërtetohet me deklaratën e donatorit, kurse vlerësimi është bërë nga departamenti i financës së Partisë. Nga verifikimi rezulton se ky vlerësim është në pajtim me çmimet e tregut.

Shpenzimet e fushatës së Partisë Socialiste për zgjedhjet e 28 Qershorit 2009 janë deklaruar në shumën 101.746.870 lekë. Kjo shumë nuk e kalon kufirin ligjor të vendosur në Ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Nga verifikimi rezulton se këto shpenzime janë të dokumentuara dhe të evidentuara në pajtim me rregullat kontabile dhe deklarata vlerësohet korrekte. Koha e kryerjes së tyre përgjithësisht përputhet me afatin zyrtar të fushatës së zgjedhjeve, por një pjesë janë kryer në mënyrë paraprake para fillimit të fushatës dhe një pjesë pas zgjedhjeve të 28 Qershorit, në vartësi nga koha e likuidimit të faturave për shërbimet e përfituara nga furnizues të ndryshëm.

Shpenzimet e kryera në total tejkalojnë të ardhurat e siguruara për fushatën në masën 8.139.430 lekë. Këto shpenzime përfaqësojnë faturat e papaguara deri në datën e këtij raporti, ndaj furnitorëve të mëposhtëm :

<u>Furnitori</u>	<u>Fatura</u>	Shuma lek
1) Marketing & Distribution	Nr.4771505040 dt.03.6.09	577.200 lekë
2) Metro sh.a.	Nr.145 dt. 22.6.2009 18.573 euro x 129.5 lekë	2.405.125 lekë
3) Advertising sh.a.	Nr.115 dt. 26.6 2009 3.866,4 euro x 129.32 lekë	500.000 lekë
4) Platea sh.a. Tiranë	Nr.141 dt.15.6.2009 16.121 euro x 131 lekë	2.111.851 lekë
5) Albtelecom sh.a.	Faturat e Qershorit për numrat e telefonave te P.S.	<u>2.545.254 lekë</u>
Gjithsej		8.139.430

lekë

Shpenzimet për **reklama** zënë vendin kryesor. Në total ato janë 67.056.776 lekë ose 65.9% të fondit të fushatës zgjedhore. Nga këto 65.242.261 lekë janë reklama televizive dhe 1.814.515 lekë për reklama në radio. Nga verifikimi rezulton se të gjitha shpenzimet janë të dokumentuara dhe të likujduara me bankë.

Sipas subjekteve mediatike reklammat janë realizuar si me poshtë :

- Top Chanel	28.004.130 lekë
- Media 6	12.490.600 lekë
- Edisud Radio TV	19.913.391 lekë
- Vizion Plus	4.834.140 lekë
- Top Albania Radio	750.115 lekë
- NRG Radio	464.400 lekë
- Muzika Jonë Radio	<u>600.000 lekë</u>
Gjithsej	67.056.776 lekë

Shpenzimet për **hapësira dhe materiale publicitare** në total kapin shumën 11.874.751 lekë. Në këtë grup Partia Socialiste ka evidentuar shpenzimet për banera,

flamuj e postera, spote e hapësira publicitare të konsumuara gjatë fushatës zgjedhore të cilat, i deklarohen të ndarë në dy grupe, si më poshtë :

City lights, tabela	11.142.751 lekë
Flamuj	732.000 lekë

Grupi i parë përfshin shpenzimet për banera e tabela ndriçuese publicitare, të përdorur kryesisht për hapjen e fushatës, por edhe gjatë saj si dhe shpenzimet për spote e hapësira publicitare. Nga verifikimi rezulton se shpenzimet për banera janë likujduar nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare në shumën 5.548.574 lekë, kurse shpenzimet për hapësira publicitare në shumën 5.594.177 lekë nuk janë likujduar deri në datën e këtij raporti, por qendrojnë si detyrime të papaguara ndaj disa kompanive të specializuara për këto shërbime, të cilat Partia Socialiste i pranon dhe i vërteton me faturat e mbërritura pranë saj.

Grupi i dytë përfshin shpenzimet për flamujt e fushatës, të përdorur kryesisht në çeljen e mbylljen e fushatës si dhe shpenzimet për postera të ndryshme publicitare të përdorur gjatë fushatës. Shpenzimet për flamuj, në shumën 220.000 lekë, janë paguar nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare, kurse shpenzimet për postera janë paguar në shumën 4000 euro (të konvertuara në 512.000 lekë) nga donatori Rudolf Dalipi Kompanisë "Dukagjini" në Pejë.

Shpenzimet për **karburant** janë në masën 1.165.000 lekë dhe janë mbuluar tërësisht nga donatorët. Gjithsej janë përfituar në natyrë 6500 litra naftë dhe 3.000 litra benzinë, të cilat janë marrë drejtpërdrejt nga shoferat në pikat e karburantit. Sasia e karburantit të përfituar vërtetohet me deklaratat e dhuruesve, kurse vlerësimi është bërë me çmimet e tregut nga Departamenti i Financës i PS. Shpenzimi i karburantit deklarohet i barabartë me shumën e përfituar e nënshkruar nga donatorët.

Shpenzimet **telefonike** 2.545.254 lekë përfaqësojnë shumën e faturuar nga Albtelecom për numrat e telefonit në përdorim nga Partia Socialiste për impulset e harxhuar gjatë fushatës që përkon me muajin Qershor 2009. Këto fatura deri në datën e nënshkrimit të këtij raporti nuk janë likujduar dhe deklarimi si fatura të papaguara është korrekt, por vendosim në vëmendjen tuaj se në shumën e këtij shpenzimi nuk janë përfshirë kamatëvonesat që rrezikon të paguajë Partia Socialiste për pagesë të vonuar.

Shpenzimet për **konsulencë** 7.960.900 lekë janë bërë për të paguar firmën konsulente amerikane Arthur J. Finkelsteing Associates Inc. S.A. për 83.000 USD dhe 134 dollarë komisione bankare. Konvertimi i dollarëve në lekë është bërë me kursin e ditës. Nga verifikimi rezulton se deklarimi i këtyre shpenzimeve është korrekt. Për shërbimin e kryer midis palëve është lidhur kontratë më 22.5.2009 dhe pagesa në dobi të firmës konsulente është kryer nëpërmjet Bankës Credins më 28.5.2009.

Shpenzimet për **muzikë** paraqiten 660.000 lekë. Nga verifikimi rezulton se ato janë kryer për prodhimin e 3000 copë CD-ve nga Super Sonic për 360.000 lekë dhe për pagesën e këngëtarëve të fushatës për 300.000 lekë. Firma Super Sonic është likuaduar nëpërmjet Bankës Credins, kurse këngëtarët janë paguar nëpërmjet arkës. Për honoraret e paguara është mbajtur tatim në burim 30.000 lekë dhe ky i është paguar Degës së Tatim- Taksave Tiranë.

Shpenzimet për **kancelari** deklarohen 1.723.598 lekë dhe përbëhen kryesisht nga shpenzimet për letër, bojë printeri, zarfa, fotokopje, etj të konsumuara në periudhën Maj-Qershor 2009. Pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve është kryer me arkë, në masën 1.217.643 lekë dhe diferenca 505.955 lekë janë paguar me bankë. Por pavarësisht nga mënyra e pagesës, blerjet e materialeve të kancelarisë në çdo rast janë të justifikuara me urdhër prokurimi të posaçëm si blerje të vogla, por harxhimi i këtyre materialeve nuk ka kaluar nëpërmjet magazinës, për të qënë nën një kontroll efikas.

Në zërin e shpenzimeve **të ndryshme** 8.760.591 lekë deklarohen shpenzimet për organizimin e hapjes së fushatës, për skeleri, foni dhe ndriçim, për sistemin audio, gjenerator, videoprojektor, bluza të stampuara të shpërndara qytetarëve, qera salle për takimet me elektoratin etj.

Sipas llojit struktura e këtyre shpenzimeve paraqitet si vijon :

- Hapja e fushatës	465.000 lekë
- Skeleri	940.000 lekë
- Sistemi audio	1.272.375 lekë
- Videoprojektor	1.305.000 lekë
- Mbyllja e fushatës	760.000 lekë
- Foni dhe ndriçim	1.310.000 lekë

- Bluza të stampuara	361.800 lekë
- Qera salle	113.925 lekë
- Shërbim dekori	1.200.000 lekë
- Telefoni papagesë	2.652 lekë
- Të tjera	<u>879.839 lekë</u>
Shuma	8.760.591 lekë

Këto shpenzime janë të dokumentuara e të likujduara të gjitha nëpërmjet llogarive bankare pranë BKT e Bankës Credins dhe deklarata e tyre me siguri të arsyeshme është e besueshme.

Si përfundim, bazuar në auditimin e kryer sipas standartit ndërkombëtar për qëllime të veçanta, me siguri të arsyeshme shpreh opinionin se pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës së Partisë Socialiste jep një pamje të vërtetë e të sigurtë të të ardhurave të realizuara dhe shpenzimeve të kryera gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Shqipërisë të dalë nga zgjedhjet e 28 Qershorit 2009.

Mihal ZIU

Ekspert Kontabël

Tiranë, 1 Nëntor 2009